

Statistikat e Bujqësisë 2018

Tiranë, 13 Qershor 2019: Në vitin 2018, prodhimi i perimeve është 1.166.283 ton, duke shënuar një rritje vjetore rreth 1,25 %, krahasuar me vitin 2017. Niveli më i lartë i prodhimit të perimeve është në qarqet Fier me 418.921 ton, Tiranë me 127.176 ton dhe Berat me 118.687 ton.


Prodhimi i drithërave në vitin 2018 është 678.196 ton, duke shënuar një rënie me 3,35 %, në krahasim me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të drithërave u arrit në qarkun e Fierit me 172.433 ton, pasuar nga qarqet Elbasan me 96.441 ton dhe Korçë me 74.969 ton.

Në vitin 2018, prodhimi i patates është 254.543 ton, duke shënuar një rritje me 1,9 %, në krahasim me vitin 2017. Qarqet që kanë nivelin më të lartë të prodhimit janë, Korça me 66.502 ton, Fieri me 46.128 ton dhe Elbasani me 27.650 ton.

Tab.1 Prodhimi bujqësor (mijë ton)

Prodhimi bujqësor	2014	2015	2016	2017	2018
Bimët e arave					
Drithëra	700,4	695,5	698,4	701,7	678,2
Perime	950,0	1.030,0	1.129,1	1.151,9	1.166,3
Patate	240,0	245,0	238,3	249,8	254,5
Fasule	30,0	28,0	25,0	21,2	24,5
Bimë industriale	5,0	4,7	4,5	3,0	3,2
Bimë medicinale	17,4	10,8	10,6	12,8	12,5
Foragjere	6.100,0	6.000,0	6.144,0	6.688,6	7.050,1
Drufrutorët					
Pemë frutore	220,0	245,0	261,0	262,6	274,3
Ullinj	98,0	96,0	99,0	107,8	117,6
Agrume	21,0	30,0	40,0	41,0	45,5
Rrush	204,0	205,0	205,1	202,9	184,8


Fig. 1 Prodhimi i drithërave, perimeve dhe patates (mijë ton)



Në vitin 2018, perimet e njoma ishin 771.724 ton duke shënuar një rritje me 3,93 %, krahasuar me vitin 2017. Prodhimi i bostanoreve ishte 281.297 ton duke shënuar një rënie me 4,86 % dhe perimet e thata 113.262 ton duke shënuar një rënie prej 0,42 %, në krahasim me vitin 2017.


Prodhimi i perimeve në serra përfaqëson 21.82 % të prodhimit gjithsej të perimeve. Prodhimi i domates në serra në termat e prodhimit ndaj prodhimit gjithsej të perimeve në serra është 54,96 % e pasuar nga trangulli dhe speci më respektivisht 27,95 % dhe 8,79 %.

Fig. 2 Struktura e prodhimit të perimeve, 2018




Në vitin 2018 u prodhuan 117.573 ton ullinj, duke pësuar një rritje 9,04 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të ullirit u arrit në qarkun e Beratit me 37.340 ton, pasuar nga qarqet Fier me 31.496 ton dhe Vlorë me 15.023 ton. Ndaj prodhimit total të ullirit, 79 % përfaqësohet nga ullinjte për vaj dhe 21 % nga ullinjte për tavolinë.

Fig.3 Ritmi i rritjes së prodhimit të ullirit (%)



Prodhimi i agrumeve në vitin 2018 është 45.499 ton duke shënuar një rritje prej 10,88 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të agrumeve u arrit në qarkun e Vlorës me 31.354 ton.

Fig 4 Ritmi i rritjes së prodhimit të agrumeve (%)



Shënime metodologjike

Statistikat e bujqësisë për vitin 2018 mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore dhe blegtorale është Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Informacioni mbledhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit. Statistikat e bimëve i referohen të dhënave vjetore si: sipërfaqe e kultivuar, sipërfaqe prodhuese për drufrutorët, prodhim dhe rendiment.

Të dhëna për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel komune. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit bimor bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.

Përkufizime

Njësia Ekonomike Bujqësore (NJEB) - është njësi e vetme, teknike ekonomike, e përcaktuar në një drejtim unik, nga terreni dhe pse në parcela jo të vazhdueshme, në të cilën realizohet prodhimi bujqësor dhe blegtoral që drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, për realizimin e veprimtarive bujqësore – blegtorale.

Njësi ekonomike bujqësore konsiderohen edhe njësitë ekonomike me drejtim të plotë blegtoral, në të cilat arrihet mbarëshimi i kafshëve pa pasur në administrim tokë bujqësore, pra ku toka nuk figuron si element përbërës i njësisë.

Tokë e punueshme

Toka e punueshme është toka arë e pluguar ose e lëruar rregullisht, sipas një sistemi të qarkullimit bimor. Sipërfaqja e kultivuar me bimë arash, është sipërfaqja e mbjellë me bimë arash në vitin bujqësor të dhënë. Këtu bëhet fjalë për sipërfaqe me kultura kryesore (të para). Kultura të kryesore janë drithërat e bukës, kulturat e pranverës misri kokërr, patatja, fasulja, bimët industriale, foragjeret shumëvjeçare, etj.

Drufrutorët

Drufrutorët përfaqësohen nga pemët frutore (frutat farore, bërthamore, subtropikale, arvore e tjera), ullinjë, agrumet, vreshtat dhe pjergullat.

Vit prodhimi

Me vit prodhimi nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

Sipërfaqja e kultivuar

Sipërfaqja e kultivuar korrespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore, specifike gjatë një viti kalendarik të dhënë. Nga kjo sipërfaqe përjashtohen sipërfaqet e dëmtuara nga dëmtues natyror (përmytjet, zjarre etj). Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e mbjella me kulturave të para dhe të dyta.

Sipërfaqja prodhuese

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja potenciale prodhuese. Përjashtohen sipërfaqet e pemëtoreve të reja, blloqet e drufrutorëve extensive dhe të degraduara.

Klasifikimi

Klasifikimi i bimëve të arave bëhet sipas grup kulturash (drithëra, perime, bimë industriale, foragjere, farëra vajore, patate, fasule) në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe e dytë.

Klasifikimi i drufrutorëve bëhet sipas: pemët frutore, ullinj, agrume, vreshta dhe pjergulla për numrin e pemëve gjithsej, pemët në prodhim, prodhimin dhe rendimentin.